

NDËRVEPRIMI DHE LIDHJA MIDIS ANTROPOLOGJISË, KULTURËS DHE SHOQËRISË

Arjan Kallço

Univeristy F. Noli Korce, Albania
E-mail:a.kallco@hotmail.com

Abstrakti

Kultura ngjan me një mekanizëm lëvizës që kënaq nevojat parësore dhe dytësore të njeriut dhe sipas Malinowskit përbëhet nga një tërësi përbërësish të integruar mirë dhe që krijon një sistem instruksionesh në lidhje me ndërvartësinë. Të gjithë ne, pra Njeriu ka nevojë për kulturë, faktorin përcaktues dhe dallues të një shoqërie, që ta kuptojë realitetin dhe t'i justifikojë zgjedhjet që bën, pra sjelljet e veta. Edhe vetë kultura si një element material dhe shpirtëror formohet vetëm nga bashkëveprimi i përhershëm dhe i domosdoshëm në kohë dhe hapësirë midis njeriut dhe mjedisit. Një vizion i tillë për kulturën është themelor. Nëse do t'i referohemi realitetit që na rrethon, kultura është i vetmi realitet i vlefshëm. Kultura e krijuar në shekuj, pra ajo kulturë që mban vulën dhe afirmimin kohor e sfidon realitetin dhe midis tyre nis një ballafaqim vlerash. Në këtë moment të tre elementët e temës hyjnë në një lidhje herë të ndashme, herë të pandashme, gati një miks konceptesh dhe idesh që edhe pse i kapërcejnë ndarjet, prirën të na japin një njohje të saktë të të gjitha vlerave që një shoqëri krijon gjatë jetës së vet. Tek rezultatet që na japin studimet dhe vlerësimet, verifikohet ballafaqimi real i vlerave dhe zëvendësimi i pashmangshëm në një zinxhrr ku disa hallka plotësohen dhe disa të tjera krijohen. Antropologjia është shkenca e tretë bashkë me sociologjinë dhe psikologjinë sociale që synon njohjen teorike të fenomeneve kulturore dhe studimin konkret të shfaqjes së tyre. Kultura është mënyra sesi e konceptojmë realitetin dhe ndjeshmëria që lidhet me të. Shoqëria është terreni ku studimet marrin jetë dhe ku kultura përpunohet çdo ditë nga vetë ajo dhe për atë. Tejlorigjori e konsideronte kulturë si gjithëpërfshirëse e aftësive dhe moduleve të sjelljes të fituara nga njeriu si anëtar i një shoqërie.